



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:195448

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06347861

C.nr.809/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.S.M nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati S.M nga Prizreni, ndaj të paditurës B me seli në Prishtinë, për shkak të objektit të kontestit – kompensim dëmi, vlera e objektit të kontestit 550.00 euro, jashtë seancës më datën 24.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit J.S.M nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, ndaj të paditurës B me seli në Prishtinë, në çështjen kontestimore C.nr.809/2024.

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi J.S.M nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, më datën 10.06.2024, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar në këtë gjykatë ka parashtruar padinë kundër të paditurës B me seli në Prishtinë, për shkak të objektit të kontestit – kompensim dëmi.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë për datën 11.09.2024, kjo gjykatë, përfaqësuesin e autorizuar të paditësit e ka detyruar që në afatin prej 15 ditëve ta paguajë taksën gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, duke e paralajmëruar me pasojat në rast se nuk e paguan taksën gjyqësore.

Në bazë të nenit 5, nenit 6.1, nenit 12 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, lidhur me nenin 253 par. 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se: “253.4 Paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkangjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar”, ndërsa sipas par. 5 të po këtij neni parashihet se: “253.5 Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t'i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 253.5 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.809/2024, më datën 24.10.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.